

Vendim nr. 178, datë 03.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Genti Ibrahimi, Anëtar

Ilir Toska, Anëtar

në datën 03.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (O) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **OLTJAN VESELI**, përfaqësuar nga avokati Jordan Daci, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1466, datë 30.09.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për rigjykim në seancë gjyqësore në Gjykatën e Lartë me trup tjetër gjykues.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 5, 7, 18, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 42, 43, 116, 122, 131, 135, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 142 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 7, 13, 14, 15, 16 dhe 17 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 4 i Protokollit nr. 7 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatore n e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është proceduar penalisht nga Prokuroria e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (*Prokuroria e Posaçme*) për veprat penale “Vjedhja me armë”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes e dhe i municionit”, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta” dhe “Kryerja e veprave nga grupi i strukturuar kriminal” të parashikuara nga nenet 140, 278, paragrafi 1, 28, paragrafi 4, 333/a, paragrafi 2, 279, paragrafi 1 dhe 334, paragrafi 1, të Kodit Penal (KP). Nga rrethanat ka rezultuar se në datën 09.04.2019, në pistën e aeroportit “Nënë Tereza”, Rinas, Tiranë, me përdorimin e armëve, është vjedhur një sasi vlerash monetare që u përkisnin tri bankave të nivelit të dytë, për të cilat ishte planifikuar të bëhej eksportimi jashtë vendit.

2. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 56 datë 05.10.2022, ka vendosur deklarinin fajtor të kërkuesit për veprat penale për të cilat akuzohej dhe dënimin e tij me 17 vjet burgim. Sipas kësaj gjykate, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi, në bashkëpunim me disa shtetas të tjerë, kanë planifikuar, kryer përgatitjet e nevojshme, siguruar mjetet e nevojshme dhe realizuar në datën 09.04.2019 vjedhjen me armë të shumave monetare në aeroportin e Rinasit.

3. Ndonëse kërkuesi dhe të bashkëpandehurit kanë paraqitur ankim, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*) me vendimin nr. 34 (87-2023-173), datë 26.07.2023. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1466, datë 30.09.2025, ka vendosur mospranimin e rekurseve të kërkuesit dhe të pandehurve të tjerë.

4. Në datën 30.03.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

5. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimet gjyqësore i janë cenuar:

5.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

5.1.1. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka respektuar nenet 115 dhe 117 të KPP-së dhe udhëzimin e ministrit të Drejtësisë nr. 353, datë 03.09.2013 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”, pasi nuk ka kryer regjistrimin audio të seancës në dhomën e këshillimit dhe nuk ka respektuar procedurat e shortit. Në fashikull gjendet një dokument pa datë për kalimin e çështjes gjyqtarit relator, ndërsa data e shqyrtimit është caktuar përpara se çështja t’i kalonte trupit gjykues. Procesverbali me shkrim nuk përmban elementet e domosdoshme, përfshirë të gjitha pretendimet dhe kundërshtimet e palëve. Gjatë gjyimit në shkallë të parë trupi gjykues është ndryshuar disa herë, për shkak të emërimeve të gjyqtarëve në gjykata të tjera, megjithatë, në shkelje të nenit 342 të KPP-së, gjykimi nuk ka filluar nga e para. Anëtarët e rinj të trupit gjykues kanë pohuar formalisht se janë njohur me aktet, të cilat ishin shumë voluminoze, ndaj garancitë nuk kanë qenë reale dhe efektive.

5.1.2. *E drejta e mbrojtjes*, pasi kërkuesit i është mohuar e drejta për t'u njohur me aktet e çështjes, duke i konsideruar ato sekrete, ndonëse çështja ishte në gjykim. Edhe pse aktet i janë dhënë mbrojtësit në CD, kjo nuk përbën zgjidhje reale, pasi fashikulli përmban 15.000 faqe dhe kërkuesi nuk përballonte dot koston e printimit. Njohja me aktet e dosjes dhe marrja e kopjeve janë lejuar pas një periudhe njëvjeçare pas fillimit të procedimit.

5.1.3. *Parimi i barazisë së armëve*, pasi mbrojtja ka kërkuar që në fillim pyetjen e njërit prej të pandehurve (fillimisht bashkëpunëtor i drejtësisë) dhe më pas ballafaqimin me kërkuesin. Vetëm pasi çështja është kthyer për plotësim hetimi nga gjyqtari i seancës paraprake, është urdhëruar kryerja e këtyre veprimeve.

- 5.1.4. *Parimi i paanshmërisë*, pasi në përbërje të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka qenë një gjyqtar, i cili ka ushtruar fillimisht detyrën në shkallë të parë dhe ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes së kërkuarit, duke marrë disa vendime të ndërmjetme në disfavor të tij. Konkretisht, ai ka vendosur në shkallë të parë rrëzimin e kërkesës së kërkuarit për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të prokurorit për marrjen e kërkuarit të pandehur dhe njoftimin e akuzës, pavlefshmërisë absolute të vendimeve të sekuestros dhe pavlefshmërisë absolute të akteve, si dhe rrëzimin e kërkesës për masën e sigurimit dhe të mosdhënies së akteve.
- 5.1.5. *E drejta e aksesit e lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve kushtetuese të kërkuarit, veçanërisht për të drejtën e mbrojtjes, për mungesën e aksesit në dokumente dhe për probleme të rënda me provat (parregullsitë në procesverbale, rezultatet e ADN-së dhe paqëndrueshmëritë e deklarimeve). Vendimeve gjyqësore u mungon analiza e provave, e fakteve dhe lidhja shkakësore. Ato janë arbitrare dhe nuk kanë koherencë. Gjykatat kanë ndryshuar kualifikimin ligjor të veprës penale pa u bazuar në vlerën e provave në raport me faktet penale. Vendimet janë stereotipe dhe disproporcionale në raport me rëndësinë e çështjes, duke cituar vetëm ato prova që i përkasin akuzës, pa shpjeguar përse janë të parëndësishme provat e mbrojtjes.
- 5.1.6. *E drejta për gjykim të drejtë*, pasi procesverbali i datës 25.04.2019 për sekuestrimin e sendeve është i panënshkruar nga personi që zotëron sendet.
- 5.2. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, i garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi fajësia e kërkuarit nuk është provuar plotësisht dhe tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Gjykatat nuk kanë arsyetuar lidhur me vlerën provuese të kampionit të pështymës së kërkuarit, që nuk përputhet me profilet gjenetike të gjetura në provat materiale që lidhen me ngjarjen, por e përmendin atë shkurtimisht. Ato nuk kanë analizuar as qëndrimin kontradiktor të bashkëpunëtorit të drejtësisë nëse njëhej ose jo me kërkuarin. Kartëmonedhat në euro të sekuestruara në banesën e kërkuarit nuk u përkasin parave të vjedhura. Gjykatat nuk kanë analizuar përgjegjësinë individuale

të kërkuesit, po e kanë trajtuar atë si pjesë të grupit kriminal, duke mos shpjeguar se cilat prova lidhen konkretisht me të, vlerën e tyre dhe nëse janë të mjaftueshme për ta shpallur fajtor.

5.3. *Parimi ne bis in idem*, pasi kërkuesi është deklaruar fajtor për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, ndonëse arma është element cilësues i veprës penale “Vjedhja me armë”. Fakti penal i pjesëmarrjes në një grup të strukturuar kriminal është përdorur për të justifikuar disa dënime: për vjedhjen me armë, mbajtjen pa leje të armëve, grupi i strukturuar kriminal dhe kryerjen e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal. Kjo qasje ka justifikuar disa dënime, duke mbivendosur figurat e veprave penale dhe shumëfishuar përgjegjësinë penale për të njëjtën sjellje.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

6. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

7. Kriteret paraprake të legjitimitetit janë të natyrës kumulative, çka do të thotë se mospërmbushja e vetëm njërit prej tyre mjafton që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes, vlerësohet përmbushja e një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të rrethanave dhe veçorive të rastit konkret, me synimin që vendimi të jetë sa më i qartë dhe i plotë për kërkuesin. Për rrjedhojë, është e mundur që në këtë fazë të konstatohet mospërmbushja edhe e vetëm një kriteri legjitimimi, gjë që sjell moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

8. Duke mbajtur parasysh natyrën kumulative të kriterëve të pranueshmërisë, Kolegji çmon që në rastin konkret të ndalet në analizën e shterimit të mjeteve juridike dhe të legjitimitetit *ratione materiae*.

9. Për sa i përket kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, Kolegji konstaton se kërkuuesi ka pretenduar cenimin e parimit të paanshmërisë, me argumentin se një prej gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë kishte dhënë më parë disa vendime të ndërmjetme në disfavor të tij gjatë gjykimit në shkallë të parë (*shih paragrafin 5.1.4 të vendimit*). Megjithatë, ky pretendim nuk rezulton të jetë ngritur përpara Gjykatës së Lartë, ndonëse përbërja e trupit gjykues ishte bërë publike në faqen zyrtare të saj me njoftimin e datës 18.06.2025. Duke qenë se vendimi për rekursin është marrë më 30.09.2025, kërkuuesi ka pasur mundësinë dhe kohën e mjaftueshme për të përdorur mjetin juridik të garantuar nga neni 18 i KPP-së, ndërkohë që nuk rezulton dhe as pretendohet që të ketë kërkuar përjashtimin e gjyqtarit në fjalë. Nga ana tjetër, kërkuuesi nuk argumenton mungesën e efektivitetit të këtij mjeti juridik. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se në lidhje me këtë pretendim ai nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, ndaj pretendimi nuk mund të merret në shqyrtim. Ndërsa për pretendimet e tjera, Kolegji vlerëson se kriteri i shterimit të mjeteve juridike është përmbushur, pasi kërkuuesi i ka ngritur ato, të paktën në substancë, gjatë gjykimit në të tria shkallët e juridiksionit të zakonshëm përpara se t'i drejtohej Gjykatës.

10. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, Kolegji evidenton fillimisht se, ndonëse në objektin e ankimit kushtetues individual është kundërshtuar vetëm vendimi i Gjykatës së Lartë, në përmbajtje kërkuuesi ka ngritur pretendime për të gjithë procesin gjyqësor, duke iu referuar vendimeve gjyqësore të të tria shkallëve. Konkretisht, ai ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor (në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës së mbrojtjes, parimit të barazisë së armëve, së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit dhe së drejtës për gjykim të drejtë), parimit të prezumimit të pafajësisë dhe parimit *ne bis in idem*.

11. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, kërkuuesi ka parashtruar argumente që lidhen me Gjykatën e Lartë dhe me gjykatën e shkallës së parë. Konkretisht, sipas tij, në dosjen e Gjykatës së Lartë nuk është dokumentuar rregullisht caktimi i trupit gjykues me short dhe se procedura e shqyrtimit të rekursit nuk është dokumentuar në formë dhe përmbajtje sipas kërkesave ligjore, përfshirë pasqyrimin e pretendimeve dhe kundërshtimeve të palëve (*shih paragrafin 5.1.1 të vendimit*).

12. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj karakterizohet nga funksioni gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik (*shih vendimet nr. 55, datë 07.11.2023; nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 27, datë 24.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, procedurat për caktimin e gjyqtarëve në përbërje të trupit gjykues normohen në aktet ligjore dhe nënligjore për organizimin e pushtetit gjyqësor, sipas të cilave çështjet ndahen me short dhe kompetencën për të caktuar gjyqtarët në seksione dhe trupa gjykues në çdo gjykatë e ka këshilli i gjykatës, pasi merr mendimin e mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, duke ndjekur rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

13. Në dritën e këtij standardi, Kolegji vëren se kërkuesi nuk ka paraqitur të dhëna konkrete që të tregojnë se mënyra e caktimit të trupit gjykues ka shmangur rregullat ligjore të shortit ose ka cenuar pavarësinë, paanshmërinë apo përbërjen ligjore të gjykatës që shqyrtoi rekursin. Po kështu, pretendimi për mungesën e regjistrimit audio dhe për përmbajtjen e procesverbalit nuk shoqërohet me argumente që të tregojnë se kërkuesit i është kufizuar e drejta për të paraqitur pretendimet e tij në rekurs, se është ndryshuar përmbajtja e tyre ose se ndonjë element procedural ka ndikuar në rezultatin e shqyrtimit në Gjykatën e Lartë. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se rekursi i kërkuesit është shqyrtuar *de plano* në dhomën e këshillimit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se shkaqet e ngritura nuk parashikoheshin nga ligji. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se argumentet e parashtruara nga kërkuesi janë të pamjaftueshme për të vënë në dyshim caktimin me short të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë ose zhvillimin e procedurës në përputhje me kërkesat ligjore. Për rrjedhojë, ky pretendim është haptazi i pabazuar.

14. Në lidhje me GJKKO-në e Shkallës së Parë, kërkuesi ka parashtruar se ajo nuk i ka përmbushur garancitë reale dhe efektive të gjykatës së caktuar me ligj, pasi përbërja e saj ka ndryshuar disa herë, gjyqtarët nuk janë njohur me aktet e çështjes dhe asnjëherë gjykimi nuk ka filluar nga e para, në kundërshtim me nenin 342, pika 4, të KPP-së (*shih paragrafin 5.1.1 të vendimit*). Sipas kësaj dispozite, kur, për shkaqe të përligjura, ndryshon përbërja e trupit gjykues, anëtari i ri duhet të njihet me përmbajtjen e procesit gjyqësor, përveç rastit kur vetë ai kërkon që çështja të shqyrtohet nga fillimi.

15. Ky pretendim i kërkuessit është vlerësuar si i pabazuar nga GJKKO-ja e Apelit. Ajo ka konstatuar se trupi gjykues prej tre gjyqtarësh është caktuar me short më 02.11.2020 dhe se ndryshimet e mëvonshme në përbërjen e tij kanë ardhur si pasojë e ngritjes në detyrë të disa gjyqtarëve, të cilët janë zëvendësuar çdo herë me short. Sipas asaj gjykate, këto ndryshime nuk kanë ndikuar në rregullsinë e procesit ose në vendimmarrje, pasi palët janë vënë në dijeni për përbërjen e re dhe nuk kanë paraqitur kundërshtime, gjyqtarët zëvendësues janë njohur efektivisht me aktet e çështjes dhe në asnjë rast nuk është kërkuar ose deklaruar prej tyre nevoja për rifillimin e gjykimit nga e para. Gjithashtu, ajo ka vlerësuar se nuk ka pasur zëvendësim të njëkohshëm të më shumë se një anëtari të trupit gjykues, ndaj nuk gjente zbatim neni 342, pika 4, i KPP-së.

16. Për sa më sipër, Kolegji konstaton se ky pretendim i kërkuessit ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat e zakonshme, në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural penal, dhe se ky arsyetim nuk përmban gabime faktike ose ligjore të dukshme që të vënë në dyshim respektimin e garancisë kushtetuese të gjykatës së caktuar me ligj. Në këtë drejtim, Kolegji evidenton se në seancën e datës 08.04.2021, gjyqtarja e caktuar rishtazi me short ka deklaruar se ishte njohur në tërësi me materialet e çështjes dhe se gjykimi mund të vijonte në gjendjen në të cilën ndodhej. I njëjti vlerësim është bërë edhe nga gjyqtarja tjetër e caktuar në trupin gjykues më 09.11.2021. Gjithashtu, vendimi përfundimtar i GJKKO-së së Shkallës së Parë është dhënë më 05.10.2022, pra rreth një viti pas ndryshimit të fundit në përbërjen e trupit gjykues, periudhë gjatë së cilës janë zhvilluar një numër i konsiderueshëm seancash gjyqësore, janë administruar prova dhe janë dëgjuar dëshmitarë.

17. Në këndvështrim të kësaj garancie kushtetuese, Kolegji thekson se neni 342, pika 4, i KPP-së, duke rregulluar procedurën e zëvendësimit të gjyqtarit dhe vijimin e gjykimit, synon të garantojë si ligjshmërinë e përbërjes së trupit gjykues, ashtu edhe pjesëmarrjen efektive të anëtarit të ri në formimin e bindjes gjyqësore. Kur ndryshimi prek vetëm një anëtar të trupit gjykues, vendimmarrja për fillimin ose jo të gjykimit nga e para i lihet vlerësimit të gjyqtarit të ri. Për rrjedhojë, vetëm fakti i zëvendësimit të anëtarëve të trupit gjykues gjatë procesit nuk mjafton, në vetvete, për të vënë në dyshim ligjshmërinë e përbërjes së tij ose pjesëmarrjen reale të gjyqtarëve në procesin vendimmarrës. Për sa kohë ndryshimet janë kryer sipas procedurave të parashikuara në ligj dhe nuk rezulton të jenë cenuar garancitë procedurale përkatëse, pretendimi i kërkuessit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është haptazi i pabazuar.

18. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për gjykim të drejtë, kërkuesi ka parashtruar se procesverbali i datës 25.04.2019 për sekuestrimin e kartëmonedhave euro nuk është nënshkruar nga personi që i zotëronte ato. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se sekuestrimi i kryer me iniciativë nga Policia Gjyqësore është zhvilluar në përputhje me nenet 208 dhe 300 të KPP-së dhe është vleftësuar nga prokurori brenda afatit ligjor. Gjithashtu, nga arsyetimi i gjykatave nuk rezulton se kartëmonedhat e sekuestruara kanë shërbyer si provë mbi të cilën është bazuar përgjegjësia penale e kërkuesit. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se gjykatat i kanë dhënë një përgjigje të arsyetuar këtij pretendimi, ndërsa vetë kërkuesi nuk ka argumentuar sesi kjo parregullsi e pretenduar ka cenuar të drejtat e tij kushtetuese. Për rrjedhojë, ky pretendim është haptazi i pabazuar.

19. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së mbrojtjes, kërkuesi ka parashtruar se i është mohuar e drejta për t'u njohur me aktet e çështjes, ndonëse nuk rrezikohej sekreti hetimor. Sipas tij, aktet i janë vënë në dispozicion me vonesë, në format elektronik dhe ishin shumë voluminoze (*shih paragrafin 5.1.2 të vendimit*).

20. Gjykata ka theksuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal, e garantuar nga neni 31, shkronja "b", i Kushtetutës, nuk duhet të pengohet. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, nga procesverbali i seancës së datës 21.09.2020, Kolegji vëren se kërkuesi dhe mbrojtësi i tij janë njohur më 09.06.2020 me vendimin e prokurorit të datës 08.06.2020 për marrjen e tij si të pandehur dhe njoftimin e akuzës. Në të njëjtën datë, kërkuesi është pyetur në cilësinë e të pandehurit dhe ka kërkuar të njihet me aktet e procedimit dhe të ripyetet në një moment të mëvonshëm. Po ashtu, me aktin e njoftimit për përfundimin e hetimeve, të datës 08.06.2020, kërkuesi dhe mbrojtësi i tij janë njoftuar për përfundimin e hetimeve dhe janë vënë në dijeni të të drejtave të parashikuara nga neni 327 i KPP-së, përfshirë të drejtën për t'u njohur me aktet dhe për të marrë kopje të tyre. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se fakti që aktet i janë vënë në dispozicion kërkuesit në formë elektronike dhe në një moment të mëvonshëm nuk përbën, në vetvete, argument të mjaftueshëm kushtetues për të mbështetur pretendimin për cenimin e së drejtës së mbrojtjes. Për më tepër, rezulton se kërkuesi ka qenë i përfaqësuar gjatë gjithë procesit nga avokatë të zgjedhur prej tij, të cilët kanë marrë pjesë në procedim dhe kanë ushtruar

të drejtat procedurale të mbrojtjes. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk ngre çështje kushtetuese për shqyrtim dhe është haptazi i pabazuar.

22. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit të barazisë së armëve*, kërkuesi ka parashtruar se pyetja e të pandehurit bashkëpunëtor i drejtësisë dhe ballafaqimi i tij me kërkuesin janë kryer me vonesë, vetëm pasi çështja është kthyer për plotësim hetimi nga gjyqtari i seancës paraprake.

23. Neni 31, shkronja “d”, i Kushtetutës parashikon se kushdo gjatë procesit penal ka të drejtën t’u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë fakte. Gjykata ka pohuar se parimi i barazisë së armëve kërkon që palëve në proces t’u garantohen mundësi të barabarta për t’u shprehur për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që lidhen me çështjen në shqyrtim (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 28, datë 22.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në dritën e këtij standardi, Kolegji vëren se kërkuesi nuk ka argumentuar sesi vonesa në marrjen në pyetje të një dëshmitari (i bashkëpandehur) gjatë fazës së hetimeve paraprake e ka vendosur atë në pozitë të pafavorshme ndaj prokurorisë ose i ka kufizuar në mënyrë konkrete ushtrimin e të drejtave të mbrojtjes. Për më tepër, qëndrimi i të bashkëpandehurit është shqyrtuar nga gjykatat, të cilat kanë vlerësuar se gjatë fazës së hetimit të çështjes ky dëshmitar ka dhënë deklaramë lidhur me rrethanat dhe gëzonte statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë, ndërsa gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor nuk iu përmbajt marrëveshjes. Gjykatat kanë vlerësuar të besueshme deklaramet e bëra gjatë fazës së hetimeve, të cilat, sipas saj, kanë gjetur mbështetje në provat e tjera. Në këto kushte, ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

25. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *parimit ne bis in idem*, kërkuesi ka parashtruar dy argumente: (i) ai nuk mund të deklarohej fajtor për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, për sa kohë arma përbën një element cilësues të veprës penale “Vjedhja me armë”; (ii) fakti penal i pjesëmarrjes në grupin e strukturuar kriminal nuk mund të përdoret për të justifikuar dënime penale të shumëfishta për disa figura veprash penale (*shih paragrafin 5.3 të vendimit*).

26. Parimi *ne bis in idem*, i garantuar nga neni 34 i Kushtetutës, ndalon dënimin ose gjykimin më shumë se një herë për të njëjtën veprë penale. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se kriteri i “së njëjtës veprë” lidhet me të njëjtin fakt ose sjellje konkrete që përbën bazën

e procedimit penal, pavarësisht cilësimit ligjor të saj (shih vendimet nr. 47, datë 05.10.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 33, datë 22.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

27. Kolegji vëren se gjykatat e faktit kanë analizuar se veprimet e kërkuarit përmbushin, ndër të tjera, elementet e figurave të veprave penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” dhe “Vjedhja me armë”, duke interpretuar dhe zbatuar nenet 278 dhe 140 të KP-së. Ato kanë vënë në dukje se arma luftarake është mbajtur nga kërkuari përpara dhe pas kryerjes së veprës penale të vjedhjes me armë. Në këtë mënyrë, sipas gjykatave, këto vepra penale konkurrojnë dhe kërkuari duhet të përgjigjet penalisht për secilën prej tyre. Kolegji çmon se ky arsyetim nuk ngre çështje në këndvështrim të parimit *ne bis in idem*, pasi secila prej veprave penale mbështetet në elemente faktike dhe juridike të dallueshme. Konkretisht, vepra penale e mbajtjes pa leje të armëve luftarake konsumohet nga vetë fakti i mbajtjes së armës pa autorizimin e kërkuar nga ligji, ndërsa vjedhja me armë lidhet me përdorimin e armës si mjet për realizimin e përvetësimit të pasurisë së tjetrit. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit *ne bis in idem*, i mbështetur në argumentin që lidhet me dënimin për këto dy vepra penale, është haptazi i pabazuar.

28. Lidhur me argumentin tjetër (pjesëmarrja në grupin e strukturuar kriminal), mbi të cilin kërkuari ka bazuar pretendimin për cenimin e parimit *ne bis in idem*, Kolegji evidenton se ai ka marrë përgjigje nga gjykatat e zakonshme. Ato kanë vlerësuar se neni 334 i KP-së, në raport me nenin 28, paragrafët 5 e 6 të këtij kodi, nuk është një vepër penale më vete, por një dënim që i shtohet dënimit të caktuar nga gjykata për veprën penale konkrete të kryer nga pjesëmarrësi në një grup të strukturuar kriminal. Sipas gjykatave të zakonshme, veprat penale të parashikuara në nenet 333 dhe 333/a të KP-së janë vepra penale formale, pra personi dënohet për kryerjen e këtyre veprave (në formën e krijimit, organizimit, drejtimit ose pjesëmarrjes), pavarësisht nëse kryen ose jo ndonjë vepër penale konkrete.

29. Arsyetimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm është në përputhje edhe me qëndrimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit zbatimi i nenit 334 të KP-së, kur vepra penale kryhet në rrethanën cilësuese të bashkëpunimit në formën e krimit të organizuar, nuk cenon parimin *ne bis in idem*. Në këto raste, neni 334 i KP-së nuk parashikon një vepër penale autonome, por shton masën e dënimit për veprën konkrete të kryer, duke e cilësuar atë si të kryer në kuadër të organizatës kriminale ose grupit të strukturuar kriminal (shih vendimin nr. 42, datë 05.04.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese). Në të njëjtën linjë,

edhe jurisprudenca njësuere e Gjykatës së Lartë ka theksuar se: (i) neni 334 i KP-së parashikon një dënim shtesë që i bashkëngjitet dënimit për veprën penale konkrete, ndërsa nenet 333 dhe 333/a të KP-së parashikojnë vepra penale autonome; (ii) ligji penal ndëshkon jo vetëm kryerjen e veprave penale në kuadër të një organizate kriminale ose grupi të strukturuar kriminal, por edhe vetë krijimin, organizimin, drejtimin ose pjesëmarrjen në to; (iii) neni 334 i KP-së nuk zbatohet në mënyrë të pavarur, por vetëm në lidhje me një vepër penale konkrete (*shih vendimin 00-2024-2155(107), datë 24.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

30. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se, në rastin e kërkuarit, gjykatat e zakonshme nuk e kanë trajtuar nenin 334 të KP-së si një akuzë të pavarur, por si rrethanë cilësuese të veprës penale të trafikimit të lëndëve narkotike, ndërsa përgjegjësinë penale për pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal e kanë vlerësuar më vete mbi bazën e nenit 333/a të KP-së. Kjo mënyrë interpretimi dhe zbatimi është në përputhje me jurisprudencën njësuere të Gjykatës së Lartë, çka mbështet përfundimin se ligji penal ka qenë i parashikueshëm në zbatimin e tij dhe se interpretimi i dhënë nga gjykatat e zakonshme nuk rezulton të ketë qenë i paparashikueshëm ose në kundërshtim të dukshëm me përmbajtjen e dispozitave të zbatuara. Për më tepër, për sa kohë nenet 333/a dhe 334 të KP-së rregullojnë situata juridike të ndryshme, nuk rezulton që gjykatat t'i kenë atribuar të njëjtës sjellje penale dy dënime penale, në kundërshtim me parimin *ne bis in idem*. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e këtij parimi nuk mbështetet në argumente kushtetuese të mjaftueshme.

31. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit*, kërkuari ka parashtruar se Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij me natyrë kushtetuese. Sipas tij, vendimet e gjykatave të zakonshme nuk përmbajnë një analizë të plotë të provave, të fakteve dhe të lidhjes shkakësore, ndërsa arsyetimi i tyre karakterizohet nga mungesa e koherencës dhe arbitraritetit. Po kështu, në mbështetje të pretendimit për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, kërkuari ka parashtruar se gjykatat nuk kanë arsyetuar mbi vlerën provuese të kampionit të pështymës së tij, nuk kanë vlerësuar natyrën kontradiktore të deklarimeve të të bashkëpandehurit dhe nuk kanë analizuar faktin se kartëmonedhat euro të sekuestruara në banesën e tij nuk përkonin me paratë e vjedhura. Për rrjedhojë, sipas kërkuarit, gjykatat nuk kanë arritur të provojnë fajësinë e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

32. Nisur nga thelbi i argumenteve mbi të cilat mbështeten këto pretendime, Kolegji çmon t'i shqyrtojë ato në mënyrë të ndërlidhur, duke verifikuar nëse gjykatat e zakonshme, në procesin penal të zhvilluar ndaj kërkuesit, kanë respektuar garancitë që burojnë nga parimi i prezumimit të pafajësisë dhe u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të tij, në përputhje me standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

33. Parimi i prezumimit të pafajësisë sanksionohet nga neni 30 i Kushtetutës. Në kuptim të këtij parimi, Gjykata ka theksuar se deklarimi i fajësisë të të pandehurit duhet të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes dhe se asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, të cilat duhet të paraqiten dhe të provohen nga akuza (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Po kështu, Gjykata ka theksuar se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrë e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë, ose është i tillë që e bën gjykimin të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Në rastin konkret, Kolegji vëren se gjykatat e posaçme kanë arritur në përfundimin se kërkuesi ka marrë pjesë, së bashku me të bashkëpandehurit e tjerë, në vjedhjen me armë të shumave të mëdha monetare në ambientet e aeroportit, gjatë transferimit të tyre nga bankat e nivelit të dytë. Pas ngjarjes, autorët janë ndjekur nga Policia e Shtetit, gjatë së cilës është shkëmbyer zjarr dhe

njëri prej tyre ka humbur jetën në vendngjarje, ndërsa identiteti i tij është përcaktuar përmes veprimeve hetimore. Gjithashtu, në vendngjarje është gjetur një gjurmë papilare që ka çuar në identifikimin e një autori tjetër, i cili gjatë hetimeve paraprake ka dhënë deklaratime të detajuara që kanë ndihmuar në identifikimin e bashkautorëve të dyshuar, përfshirë edhe kërkuesin.

36. Në mbështetje të përgjegjësisë penale të kërkuesit, gjykatat kanë vlerësuar se ai njihej me të bashkëpandehurit e tjerë, rrethanë e provuar, ndër të tjera, nga deklaratimet e tyre gjatë procedimit penal. Konkretisht, njëri prej tyre deklaroi në datën 20.04.2019 se e njihte kërkuesin dhe e identifikoi atë nëpërmjet aktit të njohjes së personit me fotografi. Ky procesverbal u përdor më pas nga prokurori për të kundërshtuar deklaratimet që i njëjti i bashkëpandehur dha në gjykim. Edhe një i bashkëpandehur tjetër deklaroi, në datën 23.04.2019, se e njihte kërkuesin prej më parë. Gjykatat u mbështetën, gjithashtu, në analizën e qelizave telefonike, nga e cila rezultonte se telefonat celularë të të pandehurve, përfshirë kërkuesin, ishin loguar në të njëjtat antena, duke mbështetur përfundimin se ata kishin lëvizur në të njëjtat zona dhe në të njëjtat intervale kohore. Gjatë kontrollit të banesës së kërkuesit u sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, 9 kapsolla detonatorë, 5 fishekë arme gjahu, një shpatë dhe dy objekte metalike. Lidhur me pretendimin e kërkuesit se kampioni i pështymës së tij nuk përputhet me profilet gjenetike të gjetura në provat materiale që lidhen me ngjarjen, gjykatat e faktit i janë përgjigjur se mungesa e gjurmëve biologjike ose daktiloskopike të kërkuesit nuk përbën rrethanë që përjashton përgjegjësinë penale të tij. Ato analizuan edhe provat e paraqitura nga mbrojtja, duke marrë me rezervë deklaratimet e prindërve, vëllait dhe një kushëriri të kërkuesit, sipas të cilëve ai kishte qenë në banesë në kohën e ngjarjes, pasi këto deklaratime nuk mbështeteshin nga provat e tjera të administruara. Po kështu, edhe pse konstatuan se shuma e eurove të sekuestruara nuk u përkiste parave të vjedhura, gjykatat vlerësuan se kjo rrethanë, në raport me tërësinë e provave, nuk cenonte përfundimin mbi përgjegjësinë penale të kërkuesit.

37. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se shkaqet e ngritura në rekurs se provat nuk janë analizuar si duhet nga gjykatat dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të kësaj gjykate. Sipas Kolegjit Penal, gjykatat kanë analizuar të gjitha elementet e secilës vepër penale të konsumuar, duke arsyetuar specifikisht çdo veprim të kryer. Po kështu, fakti se nuk janë gjendur gjurmë daktiloskopike ose biologjike të të pandehurve, nuk është përjashtues për asnjë prej tyre. Për pretendimin e kërkuesit për vlerësimin e provave të aktit të ekspertimit mbi profilin gjenetik të përfituar nga kampioni i pështymës,

Gjykata e Lartë ka vlerësuar se si gjykatë ligji nuk i hyn këtij vlerësimi që është kompetencë e gjykatave të faktit. Për sa i takon pretendimit për mosarsyetimin e vendimit dhe mosplotësimin e standardit të të provuarit tej dyshimit të arsyeshëm, Gjykata e Lartë ka konstatuar se në vendimin e gjykatës së apelit janë analizuar e argumentuar provat mbi të cilat bazohet fajësia e kërkuesit, të tilla si logimi nga të njëjtat antena të aparatit telefonik, deklarinimet e të pandehurit E.P. se e njeh kërkuesin, që janë në unitet me thëniet për shoqërimin me të pandehurit e tjerë, marrëdhënia shoqërore intensive dhe fakti se kërkuesit i janë gjetur në banesë municione e armë të ftohta. Në përfundim, Kolegji Penal ka vlerësuar se vendimmarrja e gjykatave të faktit është në zbatim të drejtë të ligjit penal (material dhe procedural) dhe si e tillë shkaqet e parashtruara në rekurs nuk janë nga ato shkaqe që parashikohen në nenin 432 të KPP-së.

38. Në analizë të sa më sipër, Kolegji vlerëson se gjykatat e kanë deklaruar fajtor kërkuesin, duke shqyrtuar e vlerësuar një tërësi provash, të cilat janë analizuar në tërësi dhe në harmoni me njëra-tjetrën, ndaj nuk rezulton që ato të kenë arritur në një konkluzion *a priori* për fajësinë e tij. Vendimet e gjykatave më të ulëta janë mbështetur vetëm në faktet e paraqitura gjatë procesit gjyqësor dhe përmbajnë bazën ligjore, analizën e provave, mënyrën e zgjidhjes së çështjes, konkretisht deklarinimin e kërkuesit fajtor për veprat penale për të cilat është akuzuar. Ato gjykata nuk e kanë nisur procesin gjyqësor me bindjen se kërkuesi ka qenë fajtor dhe as kanë zhvendosur barrën e provës nga prokurori tek ai. Kolegji evidenton se këto gjykata kanë analizuar edhe pretendimet e kërkuesit në lidhje me faktin se nuk janë gjetur gjurmë biologjike që i përkasin atij, si dhe faktin se i pandehuri tjetër ka ndryshuar deklarinimet e tij gjatë gjykimit në raport me ato të dhëna në fazën e hetimeve.

39. Po kështu, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë ka dhënë mjaftueshëm argumente se përse shkaqet e ngritura në rekurs janë të papranueshme, në kushtet kur nuk ka konstatuar zbatim të gabuar të ligjit procedural ose material penal nga gjykatat më të ulëta dhe për sa kohë pretendimet e kërkuesit lidheshin me vlerësimin e provave. Arsyeimi i të tria gjykatave nuk përmban gabime faktike ose ligjore të dukshme që t'i bëjë ato arbitrare. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyesimit të vendimit janë haptazi të pabazuara.

40. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.